

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E INDUSTRIË KREATIVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2025

PROÇES VERBAL MBI ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE TË PRANIMIT

Për procedurën me objekt: *“Blerje 1 (një) Biletë udhëtimi economic class (transport ajror ndërkombëtar) Tiranë-Berlin-Tiranë dhe 1 (një) siguracion shëndeti për 1 (një) person”.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 3 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e Sistemit Dinamik për Blerjen e Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar, dhe zhvillimin me mjete elektronike”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, për nevojat e Institucionit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Lloji i procedurës së prokurimit publik: Sistemi Dinamik për Blerjen e Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar, Prokurim me vlerë të vogël me mjete elektronike,

Objekti i procedurës: *”Blerje 2 (dy) Biletë udhëtimi economic class (transport ajror ndërkombëtar) Tiranë-Budapest-Tiranë dhe 2 (dy) siguracion shëndeti për 2 (dy) persona ”*

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Afati i kryerjes së shërbimit: 2 orë nga njoftimi i fituesit/shpallja fitues.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: Data **07.02.2025, ora 13:00.**

Afati kohor për hapjen e ofertave: Data **07.02.2025, ora 13:00.**

Këto kriterë janë vlerësuar të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese , natyrën dhe vlerën e procedurës. Përkatësisht, si vijon:

I. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE TË VECANTA PËR KUALIFIKIM

Për plotësimin e kapaciteteve ligjore dhe administrative si dhe vërtetimin se kanë zotësi juridike për të lidhur kontratat, ofertuesit/ operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe dokumentojnë mbi:

A. Kriteret e Përgjithshme për kualifikim

Për plotësimin e kapaciteteve ligjore dhe administrative si dhe vërtetimin se kanë zotësi juridike për të lidhur kontratat, ofertuesi / operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrin publik të QKB dhe të ketë në objektin e veprimtarisë së tij llojin e shërbimit sipas objektit të prokurimit, si dhe të ketë statusin aktiv.

B. Kriteret e veçanta për kualifikim

- Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar.
- Siguracioni i shëndetit në udhëtim sipas specifikimeve
- Certifikatë akreditimi/vërtetim nga IATA (fotokopje)
- Vërtetim Bankar të vitit 2022, i cili të përmbajë: Emrin e Subjektit, NIPT-in, Nr. e Llogarisë, IBAN-in.

Keto kritere bazohen në Udhëzimin e APP nr.3 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e Sistemit Dinamik për Blerjen e Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar, dhe zhvillimin me mjete elektronike”, i ndryshuar, Formulari nr. 3 për Ftesën për ofertë.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të skualifikojë operatorin e renditur i pari dhe të vazhdojë procedurën me operatorin pasardhës nëse rezulton se:
 - malli nuk është sipas kërkesave së AK dhe / ose
 - nuk paraqet njërin/disa nga dokumentat e kërkuara dhe / ose
 - operatori nuk përgjigjet, brenda afateve, për realizimin e procedurës së prokurimit dhe / ose
 - nuk dorëzon dokumentacionin brenda afateve të vendosura nga AK.

Operatori ekonomik i shpallur fitues do të bëjë dorëzimin dhe kryerjen e shërbimit për një afat kohor brenda **2 orëve**, nga njoftimi i fituesit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë autoritetit kontraktor brenda **ditës së punës** nga Njoftimi i Fituesit në APP për dorëzimin e dokumentacionit.

Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të deklarimeve të rreme e të pasakta, si dhe dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara konsiderohen si kushte për skualifikim.

Kërkesat e përgjithshme dhe posaçme për kualifikim, provohen me dorëzimin e deklaratave të ofertuesit (sipas formatit të miratuar në dokumentat e konkurrimit), formularëve të dokumentave të konkurrimit, si dhe dokumentat e ofertuesit, që janë lëshuar jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga ofertuesi.

Ky kriter bazohet në nenin 26 pika 6 të VKM nr.285/2022 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

Specifikimet teknike.

➤ Specifikimet teknike.

1. Bileta për 1 (një) person:

- Nisja nga Tirana, datë 14.02.2025, paradite, jo më vonë se ora 10:15 dhe mbërritja në Berlin, në datë 14.02.2025, pasdite, jo më vonë se ora 12:45, pa tranzit.
- Kthimi nga Berlini, datë 16.02.2025, pasdite, jo më vonë se ora 13:15 dhe mbërritja në Tiranë, në datë 16.02.2025, jo më vonë se në orën 15:30, pa tranzit.
- Udhëtimi me bagazhe dore.

2. Siguracioni i shëndetit:

- Për sigurimin e shëndetit në udhëtim për 1 (një) person, sigurimi duhet të përfshijë datat 14-16 Shkurt 2025, sipas itinerarit të udhëtimit.

II. KRITERI PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE

Oferta fituese është oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Ky kriter bazohet në pikën 1, në Udhëzimin e APP nr. 3 datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e Sistemit Dinamik për Blerjen e Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar, dhe zhvillimin me mjete elektronike”, i ndryshuar.

KOMISIONI